


1. INFORMACION NË LIDHJE ME MASAT DHE FORMULARËT

Për të aplikuar për masat e investimeve 2024, ju duhet të shkarkoni dokumentacionin e nevojshëm nga faqja web e AZHBR:
<https://azhbr.gov.al/skema-kombetare-2024>.

2. SHKARKIMI I FORMULARIT TË APLIKIMIT

Bazuar në investimin e dëshiruar shkarkohet formulari i aplikimit
(**Aneksi 10 Formulari i Aplikimit**)




3. PLOTËSIMI I FORMULARIT TË APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONIT MBËSHTETËS

Formulari i aplikimit plotësohet në mënyrë elektronike **(jo me shkrim dore)**, sipas seksioneve përkatëse.

4. PLOTËSIMI I PLANIT TË BIZNESIT

Për aplikime ku vlera e investimeve të pranueshme është mbi 5,000,000 (pesë milionë) lekë duhet të dorëzohet Plani i Biznesit (**Aneksi 11 Plan Biznesi Pjesa Përshkruese dhe Aneksi 11.1 Plan Biznesi Pjesa Financiare**).



5. OFERTAT

Për çdo investim të pranueshëm duhet të dorëzohet 1 (një) ofertë origjinale. **1 ofertë origjinale** sipas **Anekseve** përkatëse, shoqëruar me datë, firmë, deklaratën për jetëgjatësinë e rrjetës, vlefshmërinë e ofertës, e firmosur dhe vulosur të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB (regjistrimi duhet të përfshijë aktivitetin për të cilin do të jepet oferta) të subjektit ofertues.

Nëse projekti i propozuar do të realizohet nga subjekte të ndryshme për komponentë të ndryshëm të investimit, atëherë duhet të dorëzohet nga një ofertë sipas kriterëve të këtij paragrafi, nga secili subjekt për komponentin që do të realizojë. **Ofertuesi/t** nuk duhet të jetë/jenë në **konflikt interesi** me njeri tjetrin dhe me **aplikantin**.



6. DORËZIMI I APLIKIMEVE

Aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve kryhen me dosje fizike në zyrat qendrore të AZHBR dhe duhet të dorëzohen nga data **30.9.2024 deri më 8.11.2024**, brenda orarit zyrtar.

Për qëllime identifikimi, aplikanti sipas statusit përkatës (**fermer individual / person fizik / juridik**), ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike. Adresa: **Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr.56, Tiranë.**



7. REFUZIMI I APLIKIMEVE



MANGËSI SKUALIFIKUESE NË PROCESIN E APLIKIMIT:



Mungesa e plotë e planit të biznesit;



Mungesa e të gjithë dokumentacionit mbështetës;



Mungesa e ofertës;



Ofertuesit janë në konflikt interesi me aplikantin;



Paraqitja e dokumenteve/deklarimeve të rreme.



8. KONTRAKTIMI

Për aplikimet që përmbushin kriteret e financimit, që rezultojnë se nuk kanë filluar investimin nga kontrolli në terren dhe për të cilët është përcaktuar vlera e tregut të përlogaritur nga AZHBR, do të nënshkruhet kontrata.

Përfituesve nga masat e mbështetjes së investimeve **9-13**, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht deri në **30%** të masës së financimit të kontraktuar.

9. MONITORIMI

Projektet për masat e investimeve monitorohen **5 (pesë) vite** nga pagesa e fundit e AZHBR.